

Ministria për Fëmijët, Familjet, Refugjatët dhe Integrimin e Landit Nordrhein-Westfalen



07.01.2021

Informacion për prindërit

fëmijët e të cilëve janë në kujdestarinë e qendrave të kujdesit ditor (kopshte/çerdhe) ose në përkujdesjet ditore (me dado/mëndeshë)

Informacion për bartësit, strukturat drejtuese, personelin

e qendrave të kujdesit ditor për fëmijët (kopshtet/çerdhet) dhe qendrave të përkujdesjes ditore për fëmijët (me dado/mëndeshë)

Kujdesi ditor për fëmijët duke nisur nga data 11.01.2021

Me vendimin e datës 05.01.2021 të Kancelares Federale dhe të Shefave/-eve të Qeverive të Landeve, bllokimi (lockdown) në mbarë Federatën është zgjatur deri në datën 31.01.2021.

Për kujdesin ditor të fëmijëve në Nordrhein-Westfalen, duke nisur nga data 11.01.2021 do të jenë fuqi rregullat e mëposhtme:

Qendrat e kujdesit ditor (kopshtet/çerdhet):

- Vijon të mbetet i vlefshëm apeli urgjent, që, në interes të shmangies së kontaktit, prindërit të kujdesen vet për fëmijët e tyre, kur dhe nëse është e mundur.

- Gjithsesi, qendrat e kujdesit ditor për fëmijët do të mbeten të hapura. Prindërit janë përgjegjës për të vendosur, nëse duan të përfitojnë ose jo nga kjo ofertë. Kërkesat për paraqitjen e një vërtetimi nga punëdhënësi, si parakusht për përfitimin e ofertës, nuk janë të lejuara.
- Aspektet në interes të fëmijës duhet të merren veçanërisht në konsideratë. Kjo do të thotë konkretisht; ofertat e kujdesit ditor për fëmijët, duhet t'u adresohen familjeve dhe t'i ftojnë ato individualisht, nëse nga pikëpamja profesionale, marrja në kujdesin e fëmijës shihet si i domosdoshëm.
- Fëmijët, të cilët janë nën kujdes për arsye të marrjes së tyre në mbrojtje, si edhe fëmijët, të cilët janë nën kujdes për shkak të vështirësive të veçanta, duhet të merren nën kujdes. Në këto raste, fusha e kujdesit duhet të përcaktohet nga drejtuesit e Zyrës për Mirëqenien e të Rinjve ose nga një person i emëruar prej saj, në marrëveshje me drejtuesit e qendrës ditore.
- Vijnë të jenë në zbatim udhëzimet e Rregullores për Koronën për Qendrat e Kujdesit, që d.m.th. midis të rriturve duhet të respektohet distanca minimale prej 1,5 metrash. Nëse distanca minimale nuk mund të respektohet, të rriturit duhet të mbajnë një mbrojtëse gojë-hundë. Duhet të merren masat e duhura higjienike dhe duhet të sigurohet gjurmueshmëria.
- Në mbarë Landin do të zbatohet ndarja në grupe, që d.m.th. përcaktimi i dhomave fikse, me përbërje fikse (gjithmonë të njëjtët fëmijë) dhe, si rregull, një staf fiks. Grupet e ndryshme nuk duhet të kenë kontakt të drejtpërdrejtë me njëri-tjetrin. Kjo vlen për të gjithë jetën përditshme edukative, për situatën e sjelljes dhe marrjes nga kopshti, në të gjithë kohën e qëndrimit në kujdes, për përdorimin e dhomave, për kohën e gjumit dhe për kohën e marrjes së ushqimit. Madhësia maksimale e një grupi duhet të korrespondojë me madhësinë përkatëse maksimale për grupet sipas shtojcës së nenit 33 B KiBiz *[Ligji për edukimin e fëmijëve]*. Motrat dhe vëllezërit duhet të frekuentojnë të njëjtin grup. Konceptet e hapura (pjesërisht të hapura) nuk zbatohen.
- Në mënyrë që të bëhet e mundur ndarja në grupe, koha e kujdesit ditor në këto qendra do të kufizohet për secilin fëmijë në 10 orë në javë, në mbarë Landin. Një kapacitet më i madh kujdesi është i mundur për sa kohë që burimet e nevojshme të personelit e lejojnë një gjë të tillë dhe për sa kohë përjashtohet një mbingarkesë e situatës së përgjithshme në institucion. Mbi modelin e përshtatshëm, vendos vet institucioni apo bartësi.

- Janë në fuqi dhe zbatohen standardet për personelin sipas KiBiz së bashku me Rregulloren për personelin.

Kujdesi ditor për fëmijët (me dado/mëndeshë):

- Vijon të mbetet i vlefshëm apeli urgjent, që, në interes të shmangies së kontaktit, prindërit të kujdesen vetë për fëmijët e tyre, kur dhe nëse është e mundur.
- Vijnë të jenë në zbatim udhëzimet e Rregullores për Koronën për Qendrat e Kujdesit, që d.m.th. midis të rriturve duhet të respektohet distanca minimale prej 1.5 metrash. Nëse distanca minimale nuk mund të respektohet, të rriturit duhet të mbajnë një mbrojtëse gojë-hundë. Duhet të merren masat e duhura higjienike dhe duhet të sigurohet gjurmueshmëria.
- Në përkujdesin ditor të fëmijëve, zbatohet trajtimi dhe përkujdesi ndaj fëmijëve brenda kornizave kohore të kontratave për përkujdesin. Në përkujdesjet ditore me më shumë se një edukator/e, edukatori/ja e përkujdesit ditor së bashku me fëmijët e caktuar për kujdestari, brenda mundësive, duhet të respektojë ndarjen fizike nga të tjerët, për të gjithë kohën kujdesit ditor.

Kjo mënyrë e kufizuar pune, për shkak të pandemisë, do të zbatohet hëpërhë për periudhën e lockdown deri më 31.01.2021.

Ditë shtesë për rastet kur fëmija është i sëmurë:

Për të lehtësuar barrën që rëndon mbi prindërit, të paktën nga pikëpamja ekonomike, Ligji Federal do të rregullohet në mënyrë të tillë, që kompensimi, për rastet e sëmundjes së fëmijës për vitin 2021, të rritet me 10 ditë për çdo prind (20 ditë për prindërit e vetëm). Kjo e drejtë do të zbatohet gjithashtu për rastet, ku fëmija do ta marrë kujdesin në shtëpi dhe në përputhje me apelin e Qeverisë së Landit për dorëheqje nga kujdesi (në kopshte/çerdhe).

Kontributetprindërore:

Ministri Dr. Stamp ka rënë dakord me Ministrin e Financave Lienenkämper për pezullimin e pagesës së kontributeve nga prindërit, në të gjithë Landin, për muajin janar. Forma e rimbursimit/lloji përlllogaritjes mund të ndryshojë nga komuna në komunë. Procedurat janë ende duke u sqaruar dhe kjo mund të zgjasë pak kohë.

Testet për punonjësit e qendrave të kujdesit ditor dhe të përkujdesjes ditore:

Të gjitha strukturat drejtuese, punonjësit e qendrave të kujdesit ditor (kopshte/çerdhe) dhe punonjësve të përkujdesjes ditore(dado/mëndeshë), mund të kryejnë testin pas pushimeve të Krishtlindjeve, deri në gjashtë herë falas dhe në një kohë të vetëzgjedhur, në periudhën ndërmjet 07.01.2021 dhe 26.03.2021. Më shumë hollësi për këtë mund të lexoni në shkresën mbi testet, të bashkangjitur këtu.

**Ministria për Fëmijët, Familjet, Refugjatët dhe Integrimin
e Landit Nordrhein-Westfalen**